




DRITARJA E EKSPORTIT DRITARE E MUNDËSIVE



DONATORËT



QEVERIA E KOSOVËS



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

AGJENCIA AMERIKANE
PËR ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
(USAID)



BANKA GJERMANE PËR ZHVILLIM
(KfW)

BASHKËPUNËTORËT



AGJENCIA SUEDEZE
PËR ZHVILLIM DHE
BASHKËPUNIM
NDËRKOMBËTAR (SIDA)



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**

FONDACIONI
KOSOVAR I
MILENIUMIT (MFK)



BANKA BOTËRORE



Financimi përfiton nga mbështetja e Bashkimit Evropian në kuadër të Fondit për Garantimin e Kredive të krijuar sipas Rregullores (EU) Nr 1287/2013 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për krijimin e Programit për Konkurrencë dhe Ndërmarrje dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME) (2014 -2020).



FONDI EVROPIAN I INVESTIMEVE (EIF)



BANKA EVROPIANE
E INVESTIMEVE
(EIB)



KORPORATA FINANCIARE
E ZHVILLIMIT
NDËRKOMBËTAR TË
SHTETEVE TË BASHKUARA
TË AMERIKËS (DFC)

INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE



Të nderuar lexues,

Kemi kënaqësinë që të prezantojmë edicionin e gjashtë të buletinit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore!

Buletini ka një mision të thjeshtë – të informojë publikun për punën, iniciativat dhe aktivitetet tona. Ky edicion i është dedikuar një teme shumë të rëndësishme në ekonominë e Kosovës, Eksportin, prandaj dhe e kemi titulluar “DRITARJA E EKSPORTIT - DRITARE E MUNDËSIVE”. Duke konsideruar rëndësinë si dhe duke e ndërlidhur me lansimin e Dritares së re garantuese të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore në bashkëpunim me USAID Kosovo Compete Activity, menduam që një buletin kushtuar kësaj teme të rëndësishme do të jetë vlerë e shtuar për informatat dhe opinionet e shumta që përmbanë. Edhe ky edicion sjell artikuj nga akterët kyç që kanë çuar përpara iniciativa dhe projekte si dhe kanë implementuar risi të shumta në këtë sektor.

Sikur edhe në edicionet tjera, edhe ky edicion përfshinë aktivitetet e zhvilluara nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore gjatë periudhës disa muajshe si: trajnime, sesione orientuese, pjesëmarrje në forume, prezantim në panele të ndryshme, si dhe shumë aktivitete tjera.

Lexim të këndshëm!

PËRMBAJTJA

04 PARATHËNIE

NORA ARIFI

Menaxhere e Lartë e Portofolit - FKGK

06 OPINIONE

ARTAN XËRXA - Ekspert për Financa të Diversifikuara - USAID Kosovo Compete Activity

10 OPINIONE

BAHRIJE DIBRA - Specialiste e lartë për sektorin e financave dhe energjisë - KfW

13 OPINIONE

DRITON NIKAJ - Menaxher për lizing - RAIFFEISEN Lizing

STORIE SUKSESI

17 INNO HOME - FABRIKË MË E RE NË TREG

18 JAHA SOLAR - KLIENTI I PARË QË SHFRYTËZOIDRITAREN GROW!

19 REC PLAST - BIZNESI QË RECIKLON 500 TONË MBETURINA DUKE PASTRUAR KOSOVËN

20 AKTIVITETET E FONDIT

20 FKGK MERR PJESË NË NGJARJEN MË TË MADHE TË ORGANIZUAR NGA AECM

20 VAZHDON FUSHATA E DRITARES GROW

20 GJASHTË VITE NGA MIRATIMI I GARANCISË SË PARË TË FKGK-SË

21 RAPORTI I BE-SË PËR KOSOVËN, VLERËSON PUNËN E FKGK-SË

21 FKGK FILLOI IMPLEMENTIMIN E DRITARES STANDARDE ME KAPITAL TË EIB

21 FKGK NË FORUMIN E SEKTORIT USHQIMOR

22 FKGK NË FORUMIN E PARTNERITETIT TË LIZINGUT TË PAJISJEVE

22 FKGK PJESË E PANELIT NË KONFERENCËN E SHOQATËS SË BANKAVE

23 SESIONET ORIENTUESE PËR INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE

24 FKGK PJESË E PANELEVE DISKUTUESE GJATË JAVËS GLOBALE TË NDËRMARRËSISË

24 FKGK NË AKADEMINË E BPB-SË

25 FKGK DHE USAID KOSOVO COMPETE ACTIVITY LANSUAN DRITAREN E EKSPORTIT

26 KCGF FILLOI KAMPANJËN PËR DRITAREN STANDARDE

Opinionet, mendimet dhe analizat e shprehura përmes artikujve të botuar nuk reflektojnë domosdoshmërisht qëndrimet e FKGK-së apo qasjen e Institucionit ndaj të njejtave.

Mirë se vini në numrin e gjashtë të buletinit të FK GK-së. Në këtë edicion kemi përzgjedhur të trajtojmë eksportin si një nga segmentet strategjike dhe ndër shtytësit kryesorë të zhvillimit ekonomik në vendin tonë. Mundësitë e zhvillimit ekonomik përmes eksportit janë të shumta. Kosova përgjatë viteve ka treguar që ka potencial për të eksportuar produkte dhe shërbime me konkurrueshmëri të lartë. Vendndodhja e saj, kostoja e ulët e prodhimit, sistemi i favorshëm tatimor si dhe popullata e re janë disa nga përparësitë e ndërmarrjeve eksportuese për depërtim më të lehtë në tregjet ndërkombëtare, dhe në këtë mënyrë të bëhen pjesë e hartës së furnizuesve.

Megjithatë, ndërmarrjet e përfshira në këtë segment shpeshherë ballafaqohen me vështirësi të natyrës së financimit, duke filluar nga mungesa e qasjes në financa për shkak të mungesës së kolateralit, e deri te mungesa e mekanizmave të tjerë të financimit që i përshtaten natyrës së operimit. Kjo ndodh për arsye se këto ndërmarrje shpeshherë konsiderohen si të vogla për bankat zhvillimore ndërkombëtare apo shumë risikoze për bankat komerciale. Duke e ditur rëndësinë e ndërmarrjeve eksportuese dhe nevojën që këto ndërmarrje mund ta kenë për të realizuar këtë potencial, që nga ditët e para të operimit, ne kemi synuar të përkrahim këtë sektor.

Lidhur me këtë, në dhjetor të 2022-tës lansuam "Dritaren e Eksportit" e cila në partneritet me bankat e vendit tonë, do t'u ofrohet bizneseve që merren me eksport, si një mundësi e re, rrjedhimisht një akselerues dhe shtytës i bizneseve, që krahas qasjes në financa, përmes "Dritares së Eksportit" të rrisin mundësitë dhe t'u hapen dyert për investime dhe plasim të produkteve e shërbimeve cilësore, jo vetëm në Kosovë e rajon, por edhe më gjerë. "Dritarja e Eksportit" që kemi filluar ta pilotojmë me bankat partnere u dedikohet të gjitha ndërmarrjeve që me investimin e tyre



NORA ARIFI

Menaxhere e Lartë e Portofolit - FK GK



Mundësitë e zhvillimit ekonomik përmes eksportit janë të shumta. Kosova përgjatë viteve ka treguar që ka potencial për të eksportuar produkte dhe shërbime me konkurrueshmëri të lartë. Vendndodhja e saj, kostoja e ulët e prodhimit, sistemi i favorshëm tatimor si dhe popullata e re janë disa nga përparësitë e ndërmarrjeve eksportuese.

planifikojnë të fillojnë plasimin e produkteve në tregjet e jashtme, apo ato që një pjesë të shitjeve të tyre tanimë e kanë të destinuar për eksport, ndërkaq me investimin e radhës planifikojnë të forcojnë dhe konsolidojnë edhe më shumë pozitën e tyre në tregjet ndërkombëtare. Ndërsa, risi te kjo dritare, janë kushtet më të favorshme, duke filluar nga mbulueshmëria më e lartë me garanci deri në 500K euro, rritja e vlerës së kredisë që mund të kualifikojë në këtë dritare deri në 3.0 milionë euro, deri te mbulimi i humbjeve në tërësi bazuar në kapitalin e ri të siguruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) përmes kredisë nga Banka Zhvillimore Evropiane.

Kjo skemë do të mbështesë të gjitha investimet në kapital qarkullues apo edhe investimet në pajisje, teknologji e patundshmëri, qëllimi i së cilave do të jetë mundësimi i bizneseve për të penetruar me cilësi të duhur në tregjet e huaja. E veçanta e kësaj dritareje është edhe komponenta jofinanciare e realizuar me mbështetje të "USAID Compete Activity" e cila do të përkrahë FKGK-në që përmes asistencës teknike të pasurojë këtë dritare me karakteristika të tjera sipas nevojës së tregut si dhe të ngrejë vetëdijen e sektorit lidhur me mundësitë e financimit dhe mekanizmat e duhur financiarë për të mbështetur realizimin e investimeve. Ndërsa ne si FKGK, na bën krenarë që, përveçse po përmbushim një objektiv mu të filleve të operimit, po ashtu jemi edhe më të përmbushur që do të jemi hallkë në zinxhirin e këtij suksesi që do të tejkalojë kufijtë kombëtarë.



"Dritarja e Eksportit" që kemi filluar ta pilotojmë me bankat partnere u dedikohet të gjitha ndërmarrjeve që me investimin e tyre planifikojnë të fillojnë plasimin e produkteve në tregjet e jashtme, apo ato që një pjesë të shitjeve të tyre tanimë e kanë të destinuar për eksport, ndërkaq me investimin e radhës planifikojnë të forcojnë dhe konsolidojnë edhe më shumë pozitën e tyre në tregjet ndërkombëtare.

Për fund, ju ftojme të lexoni artikujt e përzgjedhur në këtë botim. Njëkohësisht i falënderojmë mysafirët tanë që kontribuan në pasurimin e këtij buletini me shkrimet e tyre. Mbesim me shpresë se të gjithë do të kënaqen duke i lexuar ato.



“DRITARJA E EKSPORTIT” NJË HORIZONT I RI DREJT TREGJEVE NDËRKOMBËTARE PËR BIZNESET KOSOVARE

ARSYESHMËRIA

“Dritarja e Eksportit”, e lansuar më 15 dhjetor 2022 nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), shënon një hap të rëndësishëm në avancimin e financimit të eksporteve, rrjedhimisht edhe në zhvillimin më të hovshëm të ekonomisë kosovare, në përgjithësi. Kjo iniciativë është kurorëzim i angazhimit të përbashkët me projektin “USAID Kosovo Compete Activity” i cili fillimisht e lasnoi idenë për një dritare të veçantë, për të adresuar mungesën e një produkti specifik financiar për këtë qëllim. Rritja eksponenciale e eksportit në vitet e fundit, si dhe likuiditeti i mjaftueshëm në sektorin bankar, po ashtu kanë ndikuar në arsyeshmërinë e krijimit të kësaj dritareje. “Dritarja” është mundurë përmes kapitalit fillestar të siguruar nga Banka Europiane për Investime (BEI), e negociuar nga FKGK-ja me aprovim të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Fillimisht, kjo dritare do të mobilizojë 60 milionë euro kredi, të cilat do të garantohen (mbulohen) pjesërisht nga FKGK-ja përmes bankave partnere, duke lehtësuar në vazhdim qasjen në financim të bizneseve eksportuese. Kjo shumë kreditore mund të tingëllojë simbolike, mirëpo impakti i këtyre investimeve në rritjen e shitjeve, përmirësimeve teknologjike, zhvillimin e produkteve të reja dhe fuqisë punëtore, mund të jenë së paku dyfishi i shumës kreditore të vënë në dispozicion nga kjo dritare.

RËNDËSIA

Pse ishte e rëndësishme një dritare e tillë? Shumica e bizneseve, posaçërisht ato prodhuese, kanë pasur investime domethënëse dhe rritje të shpejtë në dekadën e fundit. Mirëpo, shumica prej tyre kanë arritur një saturim të aftësisë për financim shitesë dhe mbulim të kërkesave kreditore, të cilat ende bazohen kryesisht në kolateral. Andaj, këto vështirësi në financimin adekuat (shuma më të mëdha kreditimi, grejs periudha më të gjata,



ARTAN XËRXA

Ekspert për Financa të Diversifikuara
USAID Kosovo Compete Activity




Kjo dritare do të mobilizojë 60 milionë euro kredi, të cilat do të garantohen (mbulohen) pjesërisht nga FKGK-ja përmes bankave partnere, duke lehtësuar në vazhdim qasjen në financim të bizneseve eksportuese.

përmirësim të teknologjisë etj.) do të jenë edhe fokusi i “Dritares së Eksportit”. Po ashtu, blerja me kohë e materialeve bazë (e lëndës së parë dhe inpleteve të tjera) është shumë e rëndësishme për konkurrueshmërinë e një biznesi dhe përmbushjen me kohë dhe me kualitet të kontratave të eksportit.

RRITJA E EKSPORTEVE SI RRJEDHOJË E MUNDËSIVE NGA TREGJET E AFËRTA “NEARSHORING OPPORTUNITIES”

Për ilustrim, në tabelën vijuese, disa indikatorë të eksporteve kosovare nga viti 2017 deri në tetor të 2022-tës, reflektojnë një rritje të rëndësishme dhe eksponenciale nga viti 2020 me EUR 474M krahasuar me vitin paraprak me EUR 383M. Viti 2020 ishte vit pandemik me Covid-19, me mbyllje dhe hapje të bizneseve dhe aktiviteteve afariste, dhe përkundër këtij fakti kishte rritje prej EUR 91M apo 23.7%. Trendi i rritjes vazhdon me rritjen më domethënëse në vitin 2021 krahasuar me vitin paraprak 2020, prej EUR 281M

apo 59.1%. Po ashtu viti 2022 (10 muaj deri në tetor), krahasuar me 2021-tën shënon rritje prej EUR 108M apo 14.3%. Pra, kjo rritje eksponenciale lirisht mund t'i atribuohet rritjes së kërkesës nga tregjet evropiane dhe amerikane dhe diversifikimit të furnizimeve të tyre nga vendet aziatike, për shkak të rritjes së kostos së produkteve dhe të transportit. Kjo mundësi e re për bizneset kosovare dhe ato nga Ballkani Perëndimor, ka mundësuar këtë rritje eksponenciale të eksporteve. Nëse këtu shtohen edhe shifrat nga eksporti i shërbimeve¹, udhëhequr nga bizneset e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit (TIK), eksportet e produkteve dhe të shërbimeve do të kishin vlera shumëfish më të larta.



Burimi – Agjencia e Statistikave të Kosovës (2017-2021) & Tradeineconomics (Tetor 2022)



1 Sipas Agjencisë Kosovare për Mbështetje dhe Promovim të Investimeve (KIESA), eksporti i shërbimeve në periudhën janar – tetor 2022 ka arritur në 2.2 miliardë euro.

CILËSIA DHE STANDARDET

Rritja e eksporteve për shumë kompani kosovare ka krijuar një realitet të ri, andaj kontrolli i kualitetit dhe konsistenca në liferimin e produkteve dhe të shërbimeve të kontraktuara, janë primordiale dhe do të reflektojnë në rritjen e mëtutjeshme apo stagnimin e tyre. Shumë kompani kosovare kanë pasur sfida dhe telashe në këtë drejtim, dhe ato të cilat kanë reaguar me kohë kanë avancuar dhe rritur aktivitetin e tyre. Andaj, pajisja reale me certifikimet teknike (standardet) dhe menaxheriale ka ndikim pozitiv në rritjen e kualitetit të produkteve/shërbimeve nga Kosova, dhe rrit kredibilitetin e produkteve/shërbimeve të ofruara. Bizneset duhet të kenë kujdes në vazhdimin real të tyre pas kalimit të afatit, pasi disa ofruer të këtyre certifikimeve kanë ofruar vazhdimet vetëm bazuar në pagesat përkatëse nga bizneset. Kjo mund të duket më e lehtë për shumë biznese, mirëpo mund të kushtojë me rënie të cilësisë, dhe potencialisht, edhe me humbje të tregut dhe të klientëve nëse cilësia e produkteve bie.

PËRFITIMET NGA RITJJA E EKSPORTEVE

Përfitimet nga rritja e eksporteve janë të shumfishta dhe ndikojnë në rritjen e gjenerimit të brendshëm duke fuqizuar zinxhirin e vlerës furnizuese, shërbimet përcjellëse, si dhe kontribuojnë në rritjen e ekonomisë kosovare. Po ashtu, në një masë i zëvendësojnë importet, përkundër faktit që raporti mes importit dhe eksportit të mallrave në vitin 2022 ishte 80 me 20 për qind, në favor të importit. Andaj, me rritjen progresive të eksportit, ky trend mund të përmirësohet duke gjeneruar edhe avantazhe të tjera për ekonominë kosovare, të përkthyer në më shumë të punësuar, rritje të buxhetit shtetëror, avancim të shkathësive të fuqisë punëtore dhe përmirësim gradual të bilancit tregtar, mes tjerash.

KONKLUDIM DHE REKOMANDIME

Në fund, mund të konkludojmë që rritja e eksporteve dhe përfitimet nga tregjet e afërta janë evidente dhe kompanitë kosovare kanë përfituar në "momentumin" e krijuar, ku kontribut të padiskutueshëm kanë dhënë kompanitë dhe individët në




Përfitimet nga rritja e eksporteve janë të shumfishta dhe ndikojnë në rritjen e gjenerimit të brendshëm duke fuqizuar zinxhirin e vlerës furnizuese, shërbimet përcjellëse, si dhe kontribuojnë në rritjen e ekonomisë kosovare. Po ashtu, në një masë i zëvendësojnë importet, përkundër faktit që raporti mes importit dhe eksportit të mallrave në vitin 2022 ishte 80 me 20 për qind, në favor të importit.

Diasporë, posaçërisht në tregjet e shteteve gjermano-folëse (DACH – Gjermani, Austri, dhe Zvicër), ndjekur nga shtetet e Beneluksit dhe ato të Skandinavisë.

Si rekomandime, në fund, mund të përmenden:

- i) zgjerimi i penetrimit në tregjet evropiane dhe amerikane përmes rritjes së llojlloshmërisë dhe kualitetit të produkteve;
- ii) përmirësimi i teknologjisë prodhuese/përpunuese dhe optimizimi i proceseve të brendshme;
- iii) krijimi i partneriteteve të reja me kompani prestigjioze në sektorët e ndryshëm (p.sh. në përpunim të drurit/mobilierit, apo përpunim të ushqimit);
- iv) promovimi dhe brendimi më i mirë i produkteve përmes profesionistëve të këtyre fushave;
- v) ngritja konstante e aftësive të fuqisë punëtore dhe stimulimi adekuat për punëtorët dhe stafin meritore; përfaqësimet adekuate në panaire dhe takime me partnerët ekzistues dhe potencialë në tregjet aktuale dhe të synuara.



**Eksporti, dritare
drejt zhvillimit
ekonomik!**



FONDI KOSOVAR I SFIDËS

Kosovo Challenge Fund KCF & FONDI RAJONAL I SFIDËS - Regional Challenge Fund RCF)

Rritja e punësimit dhe konkurrueshmërisë përmes mbështetjes së Arsimit dhe Aftësisit Profesional (AAP)

I-KONTEKSTI

Rajoni i Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, ka potencial të lartë për rritje por është i kufizuar nga mungesa e personelit të kualifikuar. Rajoni i Ballkanit Perëndimor karakterizohet nga një shkallë e lartë e papunësisë, veçanërisht tek të rinjtë, ndërkohë që bizneset përballen me mungesë të kandidatëve të kualifikuar. Arsyeja për këtë paradoks qëndron në qasjen e aftësisit profesional që nuk është përshtatur me nevojat e tregut të punës

Sfida shtesë janë mungesa e ndjeshme e fondeve për shkollat e Arsimit dhe Aftësisit Profesional (AAP) dhe infrastruktura dhe pajisjet e vjetruara të aftësisit, apo që mungojnë në tërësi. Për më tepër, mësimdhënësve shpeshherë u mungojnë kompetencat e nevojshme praktike ose metodologjike për t'i përcuar në mënyrë adekuate shkathtësitë e nevojshme bazuar në pajisjet moderne.

Kjo mospërputhje mes arsimit të ofruar me kërkesat e komunitetit të biznesit, rezulton në sfidën që të trajtuarit e AAP-së nuk i përvetësojnë shkathtësitë që kërkohen urgjentisht nga punëdhënësit potencialë. Nga ana tjetër, sistemet e AAP-së në rajon vuajnë nga angazhimi i ulët i sektorit privat në përcaktimin dhe trajnimin e kualifikimeve të kërkuara.

II- FONDI I SFIDËS - CHALLENGE FUND

Punësimi mund të promovohet me sukses vetëm nëse të diplomuarit aftësohen si duhet për të hyrë në tregun e punës, duke



BAHRIJE DIBRA

Specialiste e Lartë për Sektorin e Financave dhe Energjisë - KfW



Fondet e Sfidës (KCF & RCF) janë strukturë financuese e krijuar për të rritur punësueshmërinë e të rinjve dhe për të nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve në Kosovë dhe rajon duke financuar investime në pajisje dhe infrastrukturë për projekte të përzgjedhura të trajnimit bashkëpunues të realizuara përmes partneritetit mes instituteve të aftësisit profesional dhe ndërmarrjeve.

përputhur trajnimet e ofruara në shkollat e AAP-së me nevojat e sektorit privat. Ky është qëllimi kryesor i Fondit të Sfidës, pra fuqizimi i arsimit dhe aftësimin profesional përmes investimeve të synuara.

Fondet e Sfidës (KCF & RCF) janë strukturë financuese e krijuar për të rritur punësueshmërinë e të rinjve dhe për të nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve në Kosovë dhe rajon duke financuar investime në pajisje dhe infrastrukturë për projekte të përzgjedhura të trajnimit bashkëpunues të realizuara përmes partneritetit mes instituteve të aftësimin profesional dhe ndërmarrjeve. Grantet ndahen përmes sfidës konkurruese kombëtare/rajonale. Fondi Kosovar i Sfidës (Kosovo Challenge Fund) është iniciativë e ndërmarrë nga Banka Gjermane për Zhvillim (KfW) me financim të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) me 5.8 milionë euro për grante. Partneri kryesor implementues është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në Kosovë. Paralelisht, qasja rajonale - Fondi Rajonal i Sfidës - është duke u zhvilluar për rajonin e Ballkanit Perëndimor duke përfshirë Kosovën, Shqipërinë, Maqedoninë, Serbinë, Bosnje dhe Hercegovinën, dhe Malin e Zi. Fondi Rajonal i Sfidës është

iniciuar nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim BMZ përmes Bankës Gjermane për Zhvillim KfW dhe realizohet nga Forumi i Investimeve të Odave Ekonomike të Ballkanit Perëndimor (WB6-CIF), iniciativë kjo e përbashkët e odave ekonomike nga rajoni. Vëllimi i Fondit prej 62 milionë eurosh, i siguruar përmes Kontributit Financiar Gjerman, është rritur në afërsisht 10 milionë euro falë kontributit të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), duke synuar përshkallëzim përmes thirrjeve shtesë për propozime me rritje të financimit. Zbatimi i të dy fondeve (KCF & RCF) mbështetet nga Njësia e Menaxhimit të Fondit, realizuar me konsulencën e pavarur ndërkombëtare për zbatim.

III-QASJA E FINANCIMIT

Konsorciumet e AAP-së të përbëra nga Institute të Aftësimin Profesional (IAP) të njohura ose të akredituara në nivel kombëtar dhe kompanitë private mund të aplikojnë për fondet e sfidës për të realizuar projekte bashkëpunuese të AAP-së. Fondet ndahen përmes një procesi konkurrues dhe propozimet, të zhvilluara dhe të paraqitura bashkërisht nga konsorciumet e AAP-së, do të përzgjidhen nga një panel i pavarur



ekspertësh teknikë bazuar në kriteret e paracaktuara. Konsorciumet e suksesshme do të mbështeten më pas në procesin e zbatimit nga një ekip i Menaxhmentit të Fondit, për të siguruar se janë përmbushur rezultatet më të mira të mundshme.

Parashihet që, mesatarisht, çdo propozim do të marrë 100-600 mijë euro, ndërsa partnerët privatë të konsorciumit pritet të kontribuojnë për çdo iniciativë me afro 10-15% të kostove të fondit. IAP-të do të përfitojnë nga infrastruktura përkatëse e AAP-së siç janë punëtoritë dhe pajisjet, si dhe trajnimi i mësimdhënësve të AAP-së për përdorimin e këtyre pajisjeje. Kompanitë private do të përfitojnë nga fuqia punëtore e kualifikuar dhe masat e aftësimin për AAP-në bashkëpunuese.

Procesi konkurrues zhvillohet me thirrje të hapura të publikuara nga KCF (www.kcf-kosovo.com) dhe RCF (www.rcf-wb6.org) dhe deri më tani Fondet kanë publikuar dy thirrje. Thirrja e parë në KCF përfundoi me katër konsorciume fituese të AAP-së me investime prej rreth 2 milionë euro që do të zbatohen në sektorin e AAP-së.

Interesimi i lartë i shprehur për RCF nga konsorciumet e AAP-së në Kosovë rezultoi me 10 konsorciume fituese të cilat do të sjellin investime mbi 5 milionë euro në një sektor të AAP-së në Kosovë.

IV-NDIKIMI

Investimet e projektit do të bëjnë që të ketë më shumë arsim dhe aftësim profesional relevant për tregun e punës. Kështu, personat e aftësuar do të kenë punësueshmëri më të lartë dhe, rrjedhimisht, **perspektiva dhe mundësi më të mira të punësimit (qëllimi i projektit; SDG 4)**. Para së gjithash, projekti synon të mbulojë të rinjtë dhe të rriturit e aftësuar në AAP, duke përfshirë personat e kthyer që marrin pjesë në masat e projektit (grupi i synuar). Sektori privat do të përfitojë nga numri më i madh i punonjësve potencialë që aftësohen dhe përvetësojnë shkathtësitë që dëshirojnë. Kjo do të rezultojë në rritje të **krijimit të vendeve formale të punës, me siguri më të lartë (SDG 8)**. Në planin afatgjatë, projekti do të kontribuojë **në ulje të varfërisë** si pasojë e pagave më të mira dhe numrit më të madh të **punëtorëve të shkathët (SDG 1)**.

Për më tepër, shtetet do të mbështeten në përafrimin gradual të standardeve të tyre të AAP-së me standardet e BE-së (kontributi në "Procesin e Integritimit në BE"). Gjithashtu, kjo do të lehtësojë rritjen e mobilitetit të fuqisë së kualifikuar punëtore brenda Ballkanit Perëndimor. Rritja e shkëmbimit rajonal do të kontribuojë në rritjen e stabilitetit dhe paqes në rajon.



NDIKIMI I LIZINGUT NË RITJE TË PRODHIMIT DHE EKSPORTIT NË KOSOVË

Kosova historikisht është e njohur për një ritëm të ulët të eksportit, por në vitin 2022 ka bërë një kthesë të mirë, ndryshim ky që mund të jetë i influencuar prej shumë faktorëve të cilët nuk janë të saktësuar në ndonjë hulumtim shkencor. Ne e dimë se, që nga pandemia bota përballet me një krizë të zinxhirit të furnizimeve. Lufta në Ukrainë dhe kriza në Rusi kishin influencën e saj globale për furnizime të produkteve të ndryshme. Po ashtu, Kosova më shumë se asnjëherë më parë, viteve të fundit është duke zhvilluar prodhimin e produkteve të cilat mund të eksportohen. Që t'i eksportojmë produktet, duhet të ekzistojë një standard që i përmbush kërkesat ligjore të vendeve që pretendohet të eksportohet. Prandaj, që kjo të ndodhë prodhuesit në Kosovë duhet të investojnë në pajisje të reja dhe linja prodhimi që janë eficiente. Produktet financiare japin mbështetje në zhvillim të prodhimit, në veçanti nëse përdoren produktet adekuate për financim. Në publikim të USAID-it (Janar 2023, A., Xërxa) konkludohet se "shumica e kompanive kanë arritur një saturim të aftësisë për financime shtesë dhe mbulim të kërkesave kreditore, të cilat ende bazohen kryesisht në kolateral". Ndër produktet financiare që janë ideale për rritje të prodhimit, respektivisht të eksportit, është Lizingu, duke mundësuar që të ndërtohen kapacitetet prodhuese duke **mos përdorur hipotekën si instrument të sigurimit të financimit.**

Me Lizing mund të financohen linja për prodhim të dritareve, linja për prodhim të pijeve të gazuara, pijeve alkoolike, linja për prodhim të dyshekëve, batanijeve, këpucëve, linja paketimi etj. Që të gjitha këto linja mund të jenë subjekt i financimeve me lizing, që influencojnë prodhimin dhe eksportin. Njëherit, të gjitha këto linja dhe shumë si këto që u cekën më lart, influencojnë në eksport, prandaj, mund të konsiderojmë që lizingu si produkt



DRITON NIKAJ


Menaxher për Retail Lizing
Raiffeisen Leasing Kosovo

financiar është influencues i fuqishëm i zhvillimit ekonomik, rritjes së prodhimit dhe si rrjedhojë edhe të eksportit në Kosovë. Këtë produkt tash e sa vite është duke e ofruar Raiffeisen Leasing Kosova.



"shumica e kompanive kanë arritur një saturim të aftësisë për financime shtesë dhe mbulim të kërkesave kreditore, të cilat ende bazohen kryesisht në kolateral". Ndër produktet financiare që janë ideale për rritje të prodhimit, respektivisht të eksportit, është Lizingu, duke mundësuar që të ndërtohen kapacitetet prodhuese duke mos përdorur hipotekën si instrument të sigurimit të financimit.

Në vijim jepen të dhënat statistikore për top 10 kategoritë e produkteve më të eksportuara dhe të importuara nga Kosova gjatë vitit 2022:



Burimi: Instituti Gap, <https://www.facebook.com/?fbid=545293214291616&set=a.475514194602852>

Siç shihet nga grafiku i mësipërm, eksportet e realizuara janë industri që mund të financohen të gjitha nga lizingu për pajisje të reja, zgjerim kapaciteti apo shtim i ndonjë segmenti që mund të jetë komplementar me këto produkte. Në krahun tjetër kemi top 10 produktet e importuara, që siç shihet Kosova ka ende hapësirë të investojë në disa prej tyre, siç janë produktet Medicinale, pije freskuese, produkte mishi, biskota dhe produkte të tjera buke etj. Nëse do të kishim një publikim për top 30 produktet e importit, do të viheshin re ende më shumë mundësitë që janë për zhvillimin e prodhimit të brendshëm me qëllim të uljes së importit dhe rritjes së eksportit. E gjithë kjo do të ndikonte në zhvillimin ekonomik në vend.

Lizingu ka ndikim po ashtu në fuqizimin e kompanive për rritje të fuqisë eksportuese edhe përmes produktit për financim të flotave të kamionëve për transport. Nëse blihet një kamion i ri, vlera për një kamion transporti fillon nga 100,000 euro e tutje (vetëm "koka e kamionit"). Në varësi të brendit, kostoja e rimorkios etj., mund të arrijë vlerën deri në 300,000 euro. Secila kompani ka nevojë për më shumë se një kamion. Që të sigurohet financimi për

investime të tilla kërkohet hipotekë. Por, në rastet kur investitori zgjedh të përdorë lizingun si produkt financiar, nuk i nevojitet hipotekë apo të lërë peng çfarëdo aseti tjetër. Pra, shikuar nga ky prizëm, vërehet se influencimi i lizingut si produkt financiar në eksport është i lartë nëse kemi investitorë në industri të prodhimit dhe të eksportit.



Lizingu ka ndikim po ashtu në fuqizimin e kompanive për rritje të fuqisë eksportuese edhe përmes produktit për financim të flotave të kamionëve për transport. Nëse blihet një kamion i ri, vlera për një kamion transporti fillon nga 100,000 euro e tutje (vetëm "koka e kamionit"). Në varësi të brendit, kostoja e rimorkios etj., mund të arrijë vlerën deri në 300,000 euro.

Ky produkt ndoshta mund të konsiderohet si i mirëqenë por, në realitet bën diferencë të madhe përdorimi i produktit adekuat për nevoja të rritjes së kapaciteteve transportuese, respektivisht, eksportuese.

Nisur nga zhvillimet e fundit në botë, shihet që eficaenca është parametri kryesor që përpiqen të arrijnë secila kompani, si në kursim të energjisë, në automatizim të veprimeve, rritje të eficaencës, në ulje të kostove etj., e cila arrihet kur kemi pajisje të reja apo mjete transporti të reja. Por, si çdo institucion, biznes, shtet, resurset nuk janë të pafundme, ashtu është dhe potenciali për të blerë apo kredituar. Nëse dëshirojmë të bëjmë një investim, kërkohet që kompania të ketë para të gatshme (kesh) apo të ketë asete të cilat mund të lihen si peng ose hipotekë për të siguruar financimin. Në këtë rast, lizingu, hyn si një produkt shumë racional në përdorim të aseteve për financim dhe mirëmenaxhim të parasë së gatshme për blerje të kapaciteteve prodhuese dhe transportuese. Të gjitha kompanitë prodhuese janë të informuara mirë se sa u nevojitet në vit të investojnë në pajisje të reja apo në mjete transporti. Po ashtu, kanë shënime të sakta sa është kostoja e mirëmbajtjes së pajisjeve apo mjeteve transportuese që janë të vjetra. Ky pozicion i pasqyrave financiare lidhur me koston e mirëmbajtjes, na tregon për racionalitetin e investimit në pajisje apo mjete transporti të reja duke përdorur lizingun si produkt financiar. Eksporti mund të rritet tutje vetëm kur kemi kapacitete prodhuese, transport dhe kualitet të produktit që është i pranushëm për tregun që dëshirojmë të eksportojmë.


Nëse u referohemi zhvillimeve të fundit në industrinë e transportit, që lidhet me kufizimin e emetimit të gazeve është shumë e qartë që mjetet transportuese që zakonisht janë në Kosovë, shumë shpejt nuk do të kenë mundësi të transportojnë për në shtetet e Bashkimit Europian për shkak të emetimit të lartë të gazeve. Nisur nga kjo, mendojmë se nëse bizneset pretendojnë të ruajnë këtë që kanë arritur dhe të zhvillohen tutje, duhet të planifikojnë në ripërtrijen e flotave të tyre me kusht që të mbesin konkurrentë në



FKGK-ja tash ka hapur “Dritaren e Eksportit”, që mbështet këtë segment kaq të rëndësishëm të ekonomisë përmes ofrimit të garancive për shtim të kapaciteteve prodhuese, blerje të materialeve bazë etj. Kjo “Dritare” do të mobilizojë 60 milionë euro të cilat do të garantohen pjesërisht nga FKGK-ja me qëllim financimin e bizneseve eksportuese.

treg. Instrument tjetër financiar që mund të përdoret në kombinim me lizingun është Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), ku kemi variatete të shumta në varësi të “Dritares” që është aktuale. Fondi Kosovar për Garanci Kreditore ka mundësuar për bizneset prodhuese, respektivisht eksportuese, që të kenë qasje më të lehtë në financime duke hyrë si garantues i këtyre investimeve me një përqindje të caktuar, në shumicën e rasteve deri në 50% të vlerës së financuar.

FKGK-ja tash ka hapur **“Dritaren e Eksportit”**, që mbështet këtë segment kaq të rëndësishëm të ekonomisë përmes ofrimit të garancive për shtim të kapaciteteve prodhuese, blerje të materialeve bazë etj. Kjo “Dritare” do të mobilizojë 60 milionë euro të cilat do të garantohen pjesërisht nga FKGK-ja me qëllim financimin e bizneseve eksportuese (USAID, janar 2023; A. Xërxa). Duke parë trendet e eksportit në Kosovë për vitin 2022, mundësitë e krijuara nga “Dritarja e Eksportit” nga FKGK-ja, dhe mundësitë të cilat i ofron lizingu si produkt financiar, vlerësoj që parakushtet janë të mira që Kosova për vitet 2023 dhe 2024 do të ketë rritje të theksuar në eksport.



INNO HOME FABRIKË MË E RE NË TREG

Një ide e shkëlqyer dhe investitorë të bashkuar, sjellin gjithmonë risi. Inno Home është fabrika më e re në treg që përmes leasing-ut financiar nga Raiffeisen Leasing Kosovë, skemës së Garancive të FK GK-së dhe lehtësimit nga USAID Kosova Compete Activity është pajisur me të

gjitha pajisjet e nevojshme për zhvillimin e fabrikës dhe prodhimit.

Raiffeisen Leasing ofron lehtësira financimi për pajisjet prodhuese dhe mbështet zhvillimin e industrive të ndryshme si dhe rritjen e eksporteve në Kosovë.



JAHA SOLAR KLIENTI I PARË QË SHFRYTËZOI DRITAREN GROW!

Përmes kredisë së lëshuar nga ProCredit Bank Kosova, JAHA SOLAR u bë klienti i parë që shfrytëzoi skemën garantuese të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore - GROW.

JAHA Solar eksporton mbi 50% të produkteve të saj në vendet Evropiane. Deri sot ka zhvilluar projekte në Kosovë, Mal të Zi, Shqipëri dhe Maqedoni. Në vitin 2017 kapaciteti i instalimeve ishte vetëm 1 MW, përderisa në vitin 2022 arriti kapacitetin prej 20MW dhe pritet që deri në fund të vitit të arrij kapacitetin në 30MW. "Për projektin dhe dritaren GROW kuptuam përmes ProCredit Bank njërin nga partnerët tanë kryesor për zhvillimin e projektit të solarëve në vendin tonë. Procesi i financimit ishte i lehtë, kërkesat ishin të qarta dhe procedurat ishin të shpejta.

Kredia e garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore e ka lehtësuar procesin e përfundimit të disa projekteve dhe njëherit ka ndikuar në sigurimin e rritjes së biznesit në vend" na tha Vigan Ibërdemaj – Menaxher i projekteve në JAHA Solar. Mundësia e dhënë ishte një nga problemet kryesore që lidhen me financimin e bizneseve në Kosovë. Ky investim kishte ndikim pozitiv në kohën kur u ballafaquam me krizën energjetike.

Si rezultat, shumë biznese u pavarësuan dhe zvogëluan përdorimin e energjisë së prodhuar nga termocentralet në Kosovë. Gjithashtu, kishte ndikim pozitiv edhe në aspektin mjedisor duke menjanuar lirim e gazrave serrë si dioksidi karbonit në atmosferë – tha z. Ibërdemaj.

VEPRONI ME PËRGJEGJËSI
DHE INVESTONI NË
PANELE SOLARE

 JAHA SOLAR



REC PLAST

BIZNESI QË RECIKLON 500 TONË MBETURINA DUKE PASTRUAR KOSOVËN

Fondi Kosovar për Kreditore është i përkushtuar ndaj menaxhimit të qëndrueshëm korporativ dhe ndaj përgjegjësisë sociale. Gjithnjë duke i koordinuar aktivitetet me donatorë, institucione financiare dhe rregullatorët lokalë, mundohemi t'u shërbejmë interesave afatgjate ekonomike të vendit, komunitetit të biznesit dhe shoqërisë sonë në përgjithësi.

Prandaj, kësaj rradhe kemi përzgjedhur një biznes të veçantë për këtë tregim suksesi, biznes që kontribon drejtëpërdrejtë në përmirësimin dhe pastrimin e ambientit dhe rrethit ku jetojmë, përmes mbledhjes dhe përpunimit të mbeturinave. Vitomirica, një fshat afër Pejës, regjion i cili shquhet për ajrin e pastër që ia mundëson natyra me pejsazhet e bukura të maleve përreth saj.

Sapo arritëm në fabrikën RecPlast, Shefqeti, babai dhe ideatori i gjithë këtij biznesi na mirëpret ngrohtësisht duke na treguar shumë storje nga jeta e tij interesante. Derisa prisim të vinte pronari i kompanisë (djali i Shefqetit) Fazqeti, ne kishim mundësinë të shihnim për së afërmi rëndësinë e madhe që ka mbledhja e mbeturinave dhe reciklimi i tyre.

Në një hapësirë të gjerë, të mbushur plot mbeturina plastike, hapësirë kjo që kur e paramendon dëmin që shkaktojnë në ambient sikur të ishin ende nëpër hapsirat e Kosovës, të jep të kuptosh shumë më mirë rëndësinë e konceptit të këtij lloji të biznesit.

Të gjitha mbeturinat e grumbulluara aty së pari ndahen dhe klasifikohen që pastaj të procesohen përmes makinës për reciklim, që shndërron mbeturinat në lëndë të parë. Granulat shumëngjyrëshe të plastikës, janë produkti final i përfutur nga një sërë etapash pune.

“Ruajtja e ambientit bëhet nga njerëz në nevojë” – ishte deklarata e Fazqetit që nënkupton që mbeturinat i grumbullojnë njerëz që janë të varfër ekonomikisht dhe mbledhjen e mbeturinave e kanë punë primare. Gjë që do të duhej të ishte ndryshe, pra të krijohen kushtet dhe adoptohen politika që do të zhvillojnë dhe mundësoni lehtësira për këtë lloj biznesi.

Ne në RecPlast gjatë një viti grumbullojmë dhe eliminojmë 500 tonë mbeturina nga e gjithë Kosova. Pra, puna jonë kontribuon për një Kosovë më të pastër – na tha pronari.

Përmes kredisë së garantuar nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, RecPlast ka blerë një makinë të re për reciklim, që do të rris kapacitetin e kompanisë në përpunim dhe reciklim të mbeturinave. Kur kjo përkthehet në sasinë e mbeturinave që do të grumbullohen dhe reciklohen, na tregon ndikimin pozitiv që do ta ketë për një ambient më të pastër në Kosovë.



FKGK MERR PJESË NË NGJARJEN MË TË MADHE TË ORGANIZUAR NGA AECM

Shtator 2022 - Ekipi përfaqësues i FKGK-së i përbërë nga: Rinor Gjonbalaj- Kryesues i Bordit; Besnik Berisha- Drejtor Menaxhues dhe Vjosa Balaj- Menaxhere e Lartë e Financave ishin pjesëmarrës në ngjarjen më të madhe vjetore të AECM- Shoqata Evropiane e Institucioneve Garantuese në Vjenë. Fokusi i këtij viti ishte financimi i qëndrueshëm për #NVM-të dhe #Startup-ët. FKGK u prezantua në panelin e titulluar "Të bëjmë NVM-të të përshtatshme për të ardhmen".



VAZHDON FUSHATA E DRITARES GROW

Shtator 2022 – GROW - Dritarja e rimëkëmbjes dhe mundësive të gjelbra! Kjo dritare që u lansua në qershor të vitit 2022, do të mbështesë investimet e bizneseve kosovare në energji të ripërtërishme dhe efikasitet të energjisë. FKGK - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore lansoi dritaren GROW dhe në fazën pilotuese nënshkroi marrëveshjen e parë me ProCredit Bank. Së shpejti do të nënshkruajë marrëveshje edhe me bankat tjera partnere. Gjatë shtatorit vazhdoi fushata dhe promovimi i dritares GROW në media të ndryshme digjitale dhe tradicionale.

GJASHTË VITE NGA MIRATIMI I GARANCISË SË PARË TË FKGK-SË

Shtator 2022 – Sivjet u bënë gjashtë vite nga miratimi i garancisë së parë kreditore. Përmes garantimit të kredive, Fondi ka ndikuar në përmirësimin e performancës së NMVM-ve me investimet e bëra nga kreditë e garantuara dhe ka lehtësuar qasjen në financa duke ndihmuar kështu zhvillimin e ekonomisë.

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore gjatë këtyre viteve ka ndërtuar portofol i cili ka arritur vlerën kumulative të kredive të garantuara në 471,8 milionë euro; 252,7 milionë euro garancione të miratuara të shpërndara në total 11,500 kredi deri më 31 dhjetor 2022.



RAPORTI I BE-SË PËR KOSOVËN, VLERËSON PUNËN E FKGK-SË

Shtator 2022 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore mirëpret raportin e publikuar për Kosovën nga Komisioni Evropian. Ky raport ka vlerësuar se në gjysmën e parë të këtij viti, përveç shumë aspekteve pozitive nga masat e ndërmarra në rritjen e vazhdueshme të qendrueshmërisë në sektorin financiar, rritja e garancive të dhëna nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) në kreditimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, ka ndikuar në zbutjen e ndikimit të krizës gjatë pandemisë Covid19.



FKGK FILLOI IMPLEMENTIMIN E DRITARES STANDARDE ME KAPITAL TË EIB

Tetor 2022 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore fillon implementimin e Dritares Standarde përmes kapitalit nga Banka Evropiane për Investime (EIB). FKGK filloi implementimin e marrëveshjes me Bankën Evropiane për Investime (EIB) të nënshkruar më 28 qershor 2021 ndërmjet EIB dhe Ministrisë së Financave të Kosovës. Kjo marrëveshje siguroi rritje të kapitalit për Fondin Kosovar për Garanci Kreditore i cili përmes skemave garantuese do të lehtësojë qasjen në financa për bizneset mikro, të vogla dhe të mesme, duke u mundësuar qasje në një burim më të favorshëm të financimit.



FKGK NË FORUMIN E SEKTORIT USHQIMOR

Tetor 2022 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore pjesë e panelit me temë: "Produktet financiare relevante në sektorin e ushqimit" në Forumin e sektorit ushqimor. Me këtë rast u prezantua produkti më i ri i FKGK-së – DRITARJA STANDARDE dhe veçoritë e saj. Në panel FKGK u paraqit nga drejtori menaxhues z. Besnik Berisha.



FKGK NË FORUMIN E PARTNERITETIT TË LIZINGUT TË PAJISJEVE

Tetor 2022 – Lizingu financiar është mjet i vlefshëm që mund t'i ndihmojë kompanitë të ulin kostot e larta të investimit për blerjen e pajisjeve moderne të përpunimit në sektorët e përpunimit të ushqimit dhe drurit! Së fundmi, sesioni i tretë i Forumit të Partneritetit për Qiradhënien e Pajisjeve, i organizuar nga Aktiviteti #KosovoCompete i USAID-it, ofroi informacione thelbësore dhe histori suksesi për dhënien me qira të pajisjeve. Përfaqësuesit e kompanive të sektorit privat mësuan gjithashtu për dritaren e re të Fondi Kosovare për Garanci Kreditorë për Eficiencën e Energjisë – GROW, dhe dritaren e Financave të Eksportit, të cilat ofrojnë mundësi më të mëdha dhe preferenciale financimi për NVM-të e orientuara drejt eksportit, në të gjithë sektorët e zbatueshëm. Gjithashtu, Aktiviteti #KES i USAID-it informoi kompanitë për ofertën e tyre në diagnostikimin e eficiencës së energjisë për NVM-të.



FKGK PJESË E PANELIT NË KONFERENCËN E SHOQATËS SË BANKAVE

Nëntor 2022 – “Rritja e prodhimit vendor dhe eksportit përmes lehtësimit të qasjes në financa për MSME” – ishte tema e diskutimit në panelin e organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës, me rastin e shënimit të 20 vjetorit të themelimit. Me këtë rast pjesë e panelit diskutues ishte Kryesuesi i Bordit të FKGK z. Rinor Gjonbalaj.



SESIONET ORIENTUESE PËR INSTITUCIONET E REGJISTRUARA FINANCIARE

Dhjetor 2022 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditorë pas lansimit të Dritares Standarde dhe Agro, inicoi ciklin e ri të sesioneve orientuese të disajnuara për stafin e institucioneve të regjistruara financiare. Sesionet orientuese përmbajnë informata të rëndësishme rreth veçorive të Dritares Standarde (me theks të veçantë në komponentën e eksportit), Dritares Agro si dhe Sistemin e Menaxhimit Mjedisor e Social (SMMS). Sesioni i parë u mbajt me stafin e NLB bankës për të vazhduar me sesionet për Bankën Ekonomike; Banka për Biznes; Raiffeisen Leasing Kosovo; AFK, KEP, KRK and FINCA.



Ju sjellim momente nga sesion i mbajtur me stafin e Banka Ekonomike.



Ju sjellim momente nga sesionet e mbajtura me stafin e Bankës për Biznes BPB.



Ju sjellim momente nga sesionet e mbajtura me stafin e Raiffeisen Leasing Kosovë.



Ju sjellim momente nga sesionet e mbajtura me stafin e institucioneve mikrofinanciare: AFK - Agjencioni për Financim në Kosovë KEP Trust dhe KRK - Kreditimi Rural i Kosovës.

FKGK PJESE E PANELEVE DISKUTUESE GJATE JAVES GLOBALE TE NDERMARRESISË

Dhjetor 2022 – Lehtësimi në qasjen në financa për eksport - produkt i ri financiar i Fondit të Garancisë @KosovoCredit, i zhvilluar nga USAID, u prezantua si pjesë e Javës Globale të Ndërmarrësisë. Ky produkt do të jetë i aksesueshëm për të gjitha SME-të e qëndrueshme me deri në 249 punëtorë, që operojnë në të gjithë sektorët e zbatueshëm, kryesisht në aktivitete të orientuara nga eksporti. Lehtësia e re Financiare dhe mekanizmat e tjerë financiarë u diskutuan gjatë ngjarjes së Eksportit dhe Financimit Fillestar të organizuar nga USAID #KosovoCompete Activity.



FKGK NË AKADEMINË E BPB-SË

Dhjetor 2022 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, përfaqësuar nga z. Besnik Berisha, Drejtor Menaxhues - pjesë e panelit me rastin e përmbylljes së ciklit të dytë të Akademive të Biznesit nga BPB me ç'rast u prezantua Dritarja GROW dhe veçoritë e saj.



FKGK DHE USAID KOSOVO COMPETE ACTIVITY - LANSUAN DRITAREN E EKSPORTIT

Dhjetor 2022 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore dhe USAID Kosovo Compete Activity, lansuan një dritare e re për lehtësim financiar “DRITARJA E EKSPORTIT” Përmes Dritares së Eksportit, do të mund të lëshohen garanci të reja për institucionet financiare partnere në dobi të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, veçanërisht për bizneset e fokusuara në eksport.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm përfaqësues të: Qeverisë së Republikës së Kosovës; Bankës Qendrore të Kosovës; USAID-it; Ambasadës Suedeze në Kosovë; Shoqatës së Bankave; Bizneseve nga sektoret e përpunimit të drurit, përpunimit të ushqimit, dhe Teknologjisë Informative dhe Komunikimit (TIK); Donatorëve; Bankave Komeriale; Institucioneve Mikrofinanciare dhe shumë përfaqësues, partnerë dhe bashkpunëtorë të tjerë.



KCGF FILLOI KAMPANJËN PËR DRITAREN STANDARDE

Dhjetor 2022 – FKGK është duke implementuar Dritaren Standarde përmes kapitalit të Bankës Europiane për Investime (EIB), sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet EIB dhe Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës.

Kjo dritare gjithëpërfshirëse do të lehtësojë qasjen në financa për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) si dhe financim më të favorshëm.



LANSIMI I DRITARES
SË RIMËKËMBJES
DHE MUNDËSIVE
TË GJELBRA
(GROW)

GROW Green Recovery and Opportunity Window

LANSIMI I
DRITARES SË
EKSPORTIT

**DRITARJA E
EKSPORTIT**

TË ARRITURAT
NË VITIN 2022

AMANDAMENTIMI I LIGJIT
PËR THEMELIMIN E FKGK-së

KREDIA E PARË ME
DRITAREN GROW



FONDY KOSOVAR PER GARANCI
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE





FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE
KOSOVSKI FOND ZA KREDITNO JEMSTVO
KOSOVO CREDIT GUARANTEE FUND

Buletin i FKGK-së

EDICIONI I GJASHTË | Mars 2023

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

Adresa:
Njazi Alishani Nr. 5,
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0) 38 225 600
info@fondikgk.org

www.fondikgk.org